



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE**  
**KOMISIONI I ZGJEDHJEVE**

Nr. 5 Prot.

Tiranë, më 19.4.2019

**VENDIM**

**Nr. 1 datë 19.4.2019**

**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KANDIDATËVE,  
NOMINIMIT DHE PROCEDURËS SË VOTIMIT SI DHE FAZAVE E PROCESIT  
PËR PËRZGJEDHJEN E KATËR ANËTARËVE TË SHOQËRISË CIVILE PRANË  
KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 119/ 2015 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), Komisioni i Nominuar i Zgjedhjeve pranë Këshillit,

**V E N D O S I:**

**1. Kriteret për kandidatët dhe dokumentacionet mbështetëse**

**a. Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat nominuese janë:**

- Formulari i Aplikimit;
- Kopje të Vendimit të Regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor;
- Konfirmim nga Drejtoria e Tatimeve që subjekti ka statusin “aktiv”;

**b. Kriteret që duhet të përmbushë kandidati për anëtar janë:**

- Eksperiencë 3 (tre) vjeçare në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile me fokus, fushën e kandiduar;
- Mospasja e roleve koordinuese/ drejtuese në organizata politike;

**c. Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:**

- Jetëshkrimi (CV- Curriculum Vitae);
- Letër motivimi për kontributin që mund të japë;
- Letër konfirmuese nga organizata të shoqërisë civile se kandidati ka 3 (tre) vite eksperiencë në fushën e kandiduar;
- Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin;

## **2. Nominimet, procedura e votimit dhe numërimi i votave**

- a. Të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të regjistruara dhe aktive, nominojnë kandidatët e tyre duke pasur parasysh se çdo subjekt mund të emërojë vetëm një kandidat për anëtar të KKShC-së;
- b. Aplikantëve ju lejohej një mundësi për të apeluar brenda 3 (tre) ditësh pas publikimit të listës së nominimeve të vlefshme, në rast se nominimet e tyre janë konsideruar të pavlefshme;
- c. Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së publikon në faqen e internetit Thirrje Publike për Votimin për kandidatët e vlefshëm. Subjektet votojnë për kandidatët nga lista e kandidatëve të përpiluar nga Komisioni Teknik i AMShC-së duke respektuar parimin që një organizatë mund të votojë vetëm një herë;
- ç. Komisioni Teknik i AMShC-së vijon më tej me numërimin e votave (në një seancë të hapur dhe transparente) dhe kandidatët me numrin më të madh të votave të vlefshme, shpallen automatikisht si anëtarë të KKSHC-së

## **3. Fazat e procesit të zgjedhjeve**

- a. Shpallja për propozim të kandidatëve dhe dorëzimi i dokumentave të realizohet brenda 29 (njëzetë e nëntë) ditëve;
- b. Afati i kontestimit të listës paraprake të jetë brenda 3 (tre) ditëve;
- c. Votimi online të realizohet brenda 8 (tetë) ditëve;
- ç. Numërimi i votave të kryhet brenda 7 (shtatë) ditëve;
- d. Në rast të konstatimit të përsëritjes së votës / gabime në votim, të realizohet procesi i rikonfirmimit të votimit online, brenda 7 (shtatë) ditëve;
- dh. Pas kërkesës për konfirmim lidhur me angazhimin në Këshill, nga 4 (katër) kandidatët më të votuar, të realizohet shpallja e rezultateve përfundimtare të votimit dhe emrave të anëtarëve të rinj në KKShC

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

### **PËR KOMISIONIN E ZGJEDHJEVE:**

**Z. Blendi DIBRA**

**Z. Vladimir THANO**

**Znj. Zana VOKOPOLA**